



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 269 Prot

Tiranë, nr 14.11.2020

V E N D I M

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në datën 23.7.2019, në Tiranë, mori në shqyrtim në seancë plenare publike çështjen që i përket subjektit të procedimit disiplinor:

Znj. _____, prokuror në prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, e përfaqësuar nga av. Ervikli Shehi.

OBJEKTI: Shqyrtimi i procedimi disiplinor ndaj prokurores _____, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 149, Neni 149/a, pika 1, germa “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998; “**Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**”, e ndryshuar”;

Nenet 164, pika 8, 189, pika 1, germa “a”, dhe 190, pikat 1 dhe 2, të Ligjit nr. 115/2016, “**Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë**”, i ndryshuar,

Nenet 100 - 157 e në vijim Ligji nr. 96/2016, “**Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë**”, i ndryshuar.

Ligji nr. 7905, datë 21.03.1995, “**Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë**”, i ndryshuar

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË,

pasi mori në shqyrtim në seancë plenare çështjen, dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e Komisionit Disiplinor, nëpërmjet relatorit të çështjes, z. Bujar Sheshi, dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i procedimit disiplinor për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit të zhvilluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

Pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë është depozituar kërkesa Nr. 251/31, datë 21.07.2020, "Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit [] me detyrë prokurore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Tiranë", ardhur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i shoqëruar me raportin për zhvillimin e hetimit disiplinor së bashku me dosjen hetimore, administruar në KLP me Nr.927 prot., datë 23.07.2020.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë në përfundim të hetimit disiplinor, me Vendimin nr.251/29 prot., datë 21.07.2020, ka vendosur:

- *Përfundimin e hetimit disiplinor dhe dërgimin e Raportit të Hetimit Disiplinor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates [] me detyrë prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë për shkeljen disiplinore të parashikuar në nenin 102/1 shkronja dh), të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.*
- *Propozimin e caktimit ndaj magjistrates [] të, masës disiplinore "Vërejtje publike" të parashikuar nga neni 105 paragrafi 1 shkronja a), dhe neni 107 i ligjit nr. 96.2016 "Për Statusin", për shkeljen disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1, shkronjat "dh", të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;*

Shkak për fillimin e këtij hetimi disiplinor nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është bërë informacioni mbi vetëvrasjen në mjediset e Burgut nr. 313 të shtetasit B.H.

Në informacionin e bërë publik bëhet prezent fakti se ky shtetas ndodhej me masën e sigurimit "arrest në burg" për veprën penale të "vjedhjes" të parashikuar nga neni 134 i K.Penal.

Mbi këtë indicie, me vendimin Nr.251 prot., datë 24.02.2020, është urdhëruar nga ILD, verifikimi me iniciativë i informacionit dhe marrjen e të dhënave shtesë lidhur me dyshime për vonesa në kryerjen e veprimeve procedurale hetimore apo gjyqësore që sjellin pasoja të rënda, mosveprime apo sjellje të magjistratit që sjell dëm për palët në një proces gjyqësor ose procedurë hetimore në kundërshtim me ligjin, zvarritje të hetimeve, mbi zbatimin e ligjit procedural dhe material nga ana e prokurorisë dhe gjykatës apo nxjerrje të akteve ku pjesa përshkruese- arsyetuese parashtron rrothana që janë haptazi në kundërshtim me pjesën urdhëruese ose që nuk kanë lidhje me të.

Ndërkohë, Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka përcjellë për shqyrtim pranë Zyrës së ILD-së, ankesën publike të këtij Komiteti dhe të 18 organizatave të shoqërisë civile, me anë të së cilës është kërkuar verifikimi dhe fillimi i procedimit disiplinor ndaj disa gjyqtarëve, si dhe, ndaj prokurores [] në lidhje me të njëjtat fakte.

Për këtë shkak, me vendimin nr. 251/5 prot., datë 14.04.2020 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është vendosur bashkimi i procedimeve të mësipërme për shkak të ekzistencës së të njëjtave fakte.

Me vendimin nr. 251/11 prot., datë 22.05.2020 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është vendosur fillimi i hetimit disiplinor ndaj magjistrates [] me detyrë prokurore në Prokurorinë

pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkelje disiplinore të parashikuar në nenin 102 pika 1, shkronja dh), të Ligjit Nr. 96/2016 “ Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në përfundim të cilit është kërkuar nga KLP, procedimi disiplinor ndaj kësaj prokuroreje, për shkeljen disiplinore si më sipër cituar.

II. VEPRIMET PROCEDURALE DHE VENDIME TË NDËRMJETME TË MARRA NGA KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË DHE KOMISIONI DISIPLINOR

Me administrim e kërkesës nr 251/31, të ILD-së, datë 21.07.2020, u caktua relatori i çështjes, si dhe u verifikua plotësimi i kriterëve formale të kësaj kërkesë.

Këshilli, me vendimin Nr.184, dt.30.07.2020, ka vendosur zgjatjen e afatit të caktimit të datës së zhvillimit të seancës dëgjimore¹, e cila u caktua të zhvillohej me datë 23.09.2020, ora 11.00.

Mbi bazën e kërkesës nr.1275/1 prot., datë 10.08.2020, të prokurores zj. _____, për njohjen me dosjen, i është përcjellë praktika e plotë e procedimit disiplinor së bashku me dosjen hetimore, të ardhura nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Këshilli, me vendimin nr. 190 datë 17.09.2020, ka vendosur zhvillimin e seancës dëgjimore të datës 23.09.2020, me “dyer të mbyllura” mbi bazën e propozimit të arsyetuar të Komisionit Disiplinor².

Përpara zhvillimit të seancës dëgjimore, janë administruar parashtrimet me shkrim të prokurores

Me shkresën nr. 927/2 prot., datë 08.09.2020, është dërguar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës “Kërkesë për informacion” në lidhje me gjendjen e Procedimit Penal Nr.1259, datë 24.04.2020, nisur mbi bazën e kallëzimit të shtetase Mirjeta Hasani në ngarkim të prokurores _____ . Meqenëse nga shqyrtimi i materialeve të dosjes së hetimit disiplinor të ILD, rezultoi se vendimi nr. 291, datë 09.07.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës i administruar në dosjen hetimore të ILD-së, nuk përmbante shënimin i cili vërteton se ky vendim të kishte marrë formë të prerë.

Me datë 21.09.2020, është administruar nga Komisioni Disiplinor, përgjigja e ardhur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me anë të së cilës KLP, informohet se në lidhje kallëzimin penal nr. 1259, datë 24.04.2020, nga ana e prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, është vendosur mosfillimi i procedimit penal në ngarkim të prokurores _____ .. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr. 291 dt 09.07.2020. Kundër këtij vendimi rezultoi të ishte paraqitur kërkesë ankimore para Gjykatës së Apelit Durrës.

Me shkresën nr. 1429, datë 22.09.2020, i është dërguar kërkesë për informacion, prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, në lidhje me ecurinë e procesit gjyqësor, sa i takon kërkesës ankimore në lidhje me kallëzimin penal ndaj prokurores.

Në kushtet kur ishte njoftuar zhvillimi i seancës dëgjimore me datë 23.09.2020, dhe në mungesë të përgjigjes mbi kërkesën e mësipërme, u zhvillua seanca dëgjimore sipas parashikimit, ndërkohë

¹ Neni 138, pika 3 e Ligjit Nr. 96/2016, “Për Statusin...”

² Neni 142, pika 2, germa b), e ligjit nr.96/2016, “Për Statusin...”

që pritej përgjigja nga Prokuroria e Apelit Durrës, në lidhje me kërkesën e KLP-së mbi ecurinë e shqyrtimit të ankimit në Gjykatën e Apelit Durrës, ndaj vendimit nr. 11-2020-291, datë 09.07.2020.

Caktimi i seancës dëgjimore, u bë pasi vlerësua se nuk ndodheshim përpara kushteve të mbylljes së procedimit pa seancë dëgjimore sipas përcaktimeve të në nenin 139 të Ligjit Nr. 96/2016 “Për Statusin...”.

Me datë 28.09.2020, me shkresën nr 1429/1, pas zhvillimit të seancës dëgjimore, është administruar pranë KLP, përgjigja e ardhur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës, nëpërmjet të cilës informohej se çështja që i përket kallëzimit penal ndaj prokurores subjekt procedimi, është në gjykim dhe seanca gjyqësore ishte planifikuar të zhvillohej me datë 01.10.2020, seancë e cila u shty duke u caktuar data 07.10.2020 ora 12.15 për zhvillimin e saj.

Në këto kushte, duke qenë se ndaj prokurorit subjekt procedimi, në të njëjtën kohë dhe për të njëjtin fakt penal ishte paraqitur një kallëzim penal, për të cilin gjykata nuk ishte shprehur me vendim të formës së prerë, Këshilli bazuar mbi arsyetimin dhe propozimin e Komisionit Disiplinor, me vendimin nr 212, datë 06.10.2020, vendosi pezullimin³ e këtij procedimi disiplinor deri në administrimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës në lidhje me kallëzimin penal nr. 1259, datë 24.04.2020.

Me administrimin pranë KLP-së të vendimit nr 203, datë 07.10.2020, nëpërmjet të së cilit Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. 291 të datës 09.07.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës”, duke legjitimuar vendimin e mosfillimit të procedimit penal ndaj prokurores , Këshilli vendosi revokimin e vendimit nr 212, datë 06.10.2020, dhe rifillimin e procedimit disiplinor, me vendimin nr. 268, datë 17.11.2020. Në të njëjtën ditë u zhvillua dhe seanca plenare për diskutimin e çështjes dhe vendimmarrjen përfundimtare mbi këtë procedim disiplinor.

Të gjitha vendimet e marra nga Këshilli në lidhje me këtë procedim, i janë njoftuar palëve brenda afatit 5 ditor, të parashikuar nga ligji.

III. VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Këshilli, pasi analizoi provat nga hetimi administrativ, shpjegimet dhe provat e paraqitura nga ILD dhe subjekti i procedimit disiplinor, arsyeton se:

Në themel të pretendimeve të ILD-së, mbi bazë të së cilave mbështet kërkesën për procedim disiplinor dhe propozimin për vendosjen e masës disiplinore “Vërejtje Publike”, qëndron fakti se nga ana e subjektit të procedimit disiplinor, gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore, mbi vlefësimin e masës së arrestit ndaj shtetasit B.H, nuk është kërkuar të njëjti me disa dokumente që përfaqësuesi i të arrestuarit, kërkoi të dorëzonte përpara gjykatës, por ka shprehur dakordësinë e tij që këto dokumente të dorëzoheshin pa i parë dhe pa u njohur me përmbajtjen e tyre.

Këtë mosveprim të prokurorit (këtu në cilësinë e subjektit të këtij procedimi disiplinor), ILD, e konsideron si shkelje të normave procedurale penale, që ka sjellë pasojë dëm të interesave të palëve në procedim, duke e klasifikuar si shkelje disiplinore sipas përcaktimit të nenit 102, pika 1, germa dh) të ligjit Nr 96/2016, “Për Statusin...”

3 Neni 145, në lidhje edhe me nenin 126, të Ligjit Nr. 96/2016, “Për Statusin...”

Për sa i përket mosveprimit të prokurores në lidhje me aktet e paraqitura nga avokati mbrojtjes në seancën e caktimit të masës së sigurimit personal, në vlerësim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, fakti që në këtë seancë, nga ana e mbrojtësit janë paraqitur dokumente shtesë për të cilat ajo është shprehur se duhen administruar në dosje, por pa i parë konkretisht secilën prej tyre, përbën shkelje të rregullave të procedurës për mbledhjen e provave në seancë gjyqësore, sipas praktikës gjyqësore dhe zhvillimin e një gjykimi të rregullt.

Gjykimi i zhvilluar për caktimin apo vlefësimin e masës së sigurimit personal, është pjesë përbërëse e gjithë sistemit të gjykimit të një çështje që ka për qëllim dhënien e drejtësisë, si e tillë i nënshtrohet gjithashtu zbatimit të parimeve të përgjithshme të një gjykimi të rregullt.

Doktrina por dhe jurisprudenca, si e Gjykatës së Lartë ashtu dhe asaj Kushtetuese kanë përcaktuar si kusht të zhvillimit të një procesi gjyqësor të rregullt, zbatimin e parimeve të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit⁴. Parimit të kontradiktoritetit i nënshtrohet pikërisht procesi i marrjes së provës, sepse marrja e provës në një proces të rregullt bëhet gjithnjë në kontradiktoritet. Për rrjedhojë prokurori është i detyruar që edhe gjatë procesit gjyqësor të caktimit të masës së sigurimit të zbatojë këtë parim gjatë marrjes së provave të sjella nga pala e mbrojtëse në këtë seancë. Për më tepër sipas përcaktimit të nenit 259 pika 2 të K.Pr.Penale, provat e marra në këtë seancë konsiderohen si të marra në gjykim.

Veç kësaj, parë edhe në planin e zbatimit praktik, është më se e qartë që prokurori nuk mund të mjaftohet vetëm me deklarin nëse është dakord apo jo, që materialet apo dokumentet e sjella nga mbrojtja të administrohen në fashikullin e gjykimit, por duhet patjetër të debatohet në lidhje me to, t'ia nënshtrojë analizës nëse përbejnë apo jo provë, në kuptimin e nenit 149 të K.P.Penale dhe nëse kanë lidhje apo jo me çështjen objekt gjykimi. Por të gjitha këto, nuk mund të realizohen pa i parë dhe pa i analizuar provat e sjella nga pala tjetër. Ky veprim përveçse është kusht për një proces të rregullt, por është dhe logjikë, sepse nuk mund shprehë dakordësinë apo të jetë kundër me diçka që nuk e ka parë dhe dëgjuar.

Për këtë moment, duhet theksuar se Këshilli në qëndrimin e tij, ka parasysht edhe faktin se në rast se ky mos veprim i prokurores nuk do të cilësohej si shkelje e rregullave procedurale të një procesi të rregullt gjyqësor, një vendim i tillë do të bëhej shkak që në vazhdimësi prokurorët të përdorin këtë qëndrim si precedent dhe në kundërshtim me logjikën juridike, do të neglizhonin njohjen me aktet që do të paraqiteshin nga pala e tjetër në gjykim, do mund të anashkalonin edhe dhënien e opinionit para gjykatës, nëse duhen apo nuk duhen pranuar si prova këto akte, gjë që do të krijonte probleme të diskutueshme, si në rastin konkret, apo në ndonjë rast dhe do të mund të sillnin pasoja të dëmshme për procesin penal në tërësi.

Sidoqoftë Këshilli edhe pse e vlerëson shkelje nga ana e prokurores, mos veprimin për t'u vënë në dijeni me aktet e paraqitura në gjykatë nga ana avokatit në seancën e caktimit të masës së sigurimit personal ndaj të ndjerit, për të kontrolluar këto akte në lidhje me formën dhe përmbajtjen e tyre, konstaton se shkelja nuk ka asnjë lidhje, as të drejtpërdrejtë dhe as të tërthortë me vetë varjen e të pandehurit. Edhe vetë ILD në raportin mbi hetimin disiplinor, shprehet se nuk ekziston lidhje ndërmjet shkeljes së prokurores dhe vetë varjes së të ndjerit⁵.

⁴ Vendim nr 4 i vitit 2012 dhe nr 16/2014, të Gjykatës Kushtetuese.

⁵ Shih pikën 7.3 të raportit hetimor.

Është vendi të përmendet që nga ana e ILD-së është vlerësuar si i provuar fakti që prokurorja kishte dijeni për përmbajtjen e këtyre akteve të dorëzuara nga avokati mbrojtjes në seancën e caktimit të masës së sigurimit, por dhe për gjendjen psikike të pandehurit, duke e bazuar këtë në faktin se edhe në ankimin e paraqitur nga ana e të arrestuarit në Gjykatën e Apelit është kërkuar një masë sigurimi me e butë, nga del qartë se personi nën hetim vuante nga sëmundje psikike.

Në fakt, gjatë seancës dëgjimore, ILD është pyetur konkretisht për të sqaruar këtë moment se si provohet fakti që prokurorja është njohur me dokumentet? Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjigjur se: *“e presupozon dhe e merr të mirëqenë faktin që është njohur sepse duke u njohur me ato prova ajo ka marrë edhe vendime të mëtejshme dhe këtu është përgjegjësia e prokurores...”*

Në lidhje me këtë rrethanë Këshilli arrin në përfundimin se, prokurorja edhe pse ka pasur detyrimin të njihet me aktet e mbrojtjes, ajo nuk është njohur me to dhe nuk ka pasur dijeni për gjendjen psikike të personit nën hetim. Kjo vërtetohet si nga përmbajtja e procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 11.12.2019, ashtu dhe nga përmbajtja e ankimit të paraqitur nga ana e avokatit mbrojtës i cili është shprehur vetëm se: *“është i padënuar më parë, ka sjellje shumë të mira në ambientin ku punon dhe jeton, ka fëmijë të cilët duhen ushqyer nga babi se nëna është e papunë, është me raport mjekësor kemo me një afat të gjatë për shkak të gjendjes shëndetësore...”* pra askund në asnjë moment nuk pretendon probleme psikike të pandehurit, fjala “kemo” nuk nënkupton asgjë.

Në favor të këtij konstatimi, flet dhe fakti që avokati ka kërkuar një masë sigurimi më të butë për shkak të gjendjes shëndetësore, por kjo nuk mund të çojë në përfundimin se janë paraqitur pretendime për gjendjen psikike. Si juristit në cilësinë dhe avokatit, që prezumohet profesionist i fushës, në rast se do kishte pretendime për gjendjen psikike të klientit të tij, do të kërkonte zbatimin e nenit 239 të K.Pr.Penale (Shtrim i përkohshëm në një spital psikiatrik) dhe jo masë sigurimi më të butë.

Për sa i përket thelbit të çështjes, që ka lidhje me propozimin e bërë nga ana e ILD, Këshilli arsyeton mungesën e pasojave, shkaktimin e dëmit për palët në një procedim penal.

Është vendi të sqarohet këtu se jo vetëm në rastin konkret por dhe në përgjithësi, prokurori ashtu si dhe gjyqtari në hetimin e dhe gjykimin e subjekteve të veprës penale nuk kanë detyrimin për të kontrolluar në çdo rast gjendjen psikike të pandehurit dhe nuk mund të supozojë problem të shëndetit mendor të pandehurit, për shkakun se në çdo shoqëri njerëzore normale, presupozohet që anëtarët e komunitetit të jenë njerëz normal. Pikërisht për këtë arsye, edhe Kodi i Procedurës Penale në lidhje me verifikimin e përgjegjshmërisë së të pandehurit në nenin 43 pika 1 të tij përcakton qartë se *“kur ka arsye të çmohet se për shkak të sëmundjes mendore të shkaktuar pas ngjarjes i pandehuri nuk është në gjendje të marrë pjesë me vetëdije në procedim, gjykata vendos edhe kryesisht, ekspertimin”*. Në të njëjtën linjë arsyetimi shkojnë dhe përcaktimet e pikës 3 të po këtij neni.

Nga ana e ILD, shkelja disiplinore e pretenduar klasifikohet sipas përcaktimit të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “dh”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” e cila konsideron si shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të detyrës, citojmë: *“veprimi ose mosveprimi i magjistratit që ka sjellë **dëm** për palët në një procedurë hetimore, në kundërshtim me ligjin”*. Pra sikurse vihet re, kjo shkelje disiplinore, në mënyrë që të konsiderohet e konsumuar, kërkon detyrimisht ardhjen pasojës në formën e dëmit për palët.

ILD në disa pika të raportit hetimor, ka shprehur këtë qëndrim të tij duke e përmbledhur në pikën 7.3 përfundimin e arritur se: *“Në analizë të fakteve të konstatuara, rezultoi se mosveprimi i*

prokurore: ... në drejtim të verifikimit të përgjegjshmërisë së të pandehurit B. II. solli si pasojë pengimin e aktorëve të tjerë të sistemit për të disponuar me masa të përshtatshme ndaj shëndetit mendor. Nga ana tjetër ky mosveprim solli dërgimin e çështjes në gjykim duke u kërkuar deklarimi fajtor dhe dënimi i tij me burgim, rrjedhojë e të cilës ishte dhe vijimi i procedurave gjyqësore me zhvillimin e seancës së hetimeve paraprake dhe më pas dërgimi për gjykim dhe caktimi i seancës gjyqësore, janë veprime të cilat zgjatën qëndrimin e shtetasit B.H në ambientet e IEVP "Jordan Misja". Mosveprimi i prokurores nuk rezultoi të jetë shkak i vdekjes së shtetasit B.H".

Në lidhje me këtë konstatim të Raportit të ILD, Këshilli arsyeton se shkelja e pretenduar e kryer nëpërmjet mosveprimit të prokurores së çështjes, provohet se nuk ka penguar aktoret e tjerë të sistemit për të disponuar me masa të përshtatshme ndaj shëndetit mendor.

Kështu për sa i përket gjykatës (në sqarimin e dhënë në seancë dëgjimore ILD theksoi se me aktor kishte parasysh gjykatën e shkallës së parë dhe të apelit), mosveprimi i prokurores nuk ka asnjë ndikim për arsyen se është gjykata ajo që drejton dhe administron seancën gjyqësore, që ka marrë në dorëzim dhe ka bërë vlerësimin nëse duhet t'i administrojë apo jo si prova aktet e paraqitura nga avokati mbrojtjes, sikurse vërtetohet se ka vepruar edhe në rastin konkret.

Ndryshe nga sa shprehet ILD, prokurori vërtet është "organi procedues" gjatë fazës së hetimeve paraprake, por jo në gjykim. Për çdo gjykim që zhvillohet në fazën e hetimeve paraprake, si vleftësim, caktim masë sigurimi apo sigurim prove...etj. organi procedues është gjykata jo prokurori. Vetë neni 259 i K. Pr. Penale, tek i cili referohet inspektori, në piken e dytë të tij shprehet se: ... "provat e marra në këtë seancë konsiderohen si të marra në gjykim, por me kërkesën e palëve ato mund t'i nënshtrohen debatit gjyqësor gjatë shqyrtimit të çështjes në themel.", që do të thotë se dhe në seancën e caktimit të masës së sigurimit personal, edhe pse çështja është në fazën e hetimit paraprak, prokurorin procedura e njeh si palë dhe jo si organ procedues. Thënë më thjeshtë, organ procedues është ai organ i cili drejton procedurën në një fazë konkrete të procesit dhe që mban proces-verbalin përkatës në lidhje me pasqyrimet e veprimeve të kryera në këtë moment specifik.

Parë në këtë këndvështrim, vlerësohet se si organ procedues i përket gjykatës e drejta për të marrë iniciativën për kryerjen e ekspertimit psikiatrik pavarësisht qëndrimit të prokurorit në seancë, detyrim ky i përcaktuar dhe në parashikimet e neneve 43, pika 1, 44 dhe 46 të Kodit të Procedurës Penale, duke rrëzuar kështu pretendimin e shprehur në pikën 6.2.7, të raportit hetimor, se në këtë moment procedural, detyrimi për të kërkuar këtë ekspertim i takon prokurorit sipas përcaktimit të nenit 43, pika 3.

Sidoqoftë pavarësisht sa sipër, gjatë gjithë fazës së hetimit paraprak, me përjashtimin të fazave të gjykimit, referuar nenit 278 të K.Pr.Penale, prokurori konsiderohet si organ procedues, pra ai ka përgjegjësinë për marrjen e vendimit për kryerjen e ekspertimit psikiatrik, por gjithnjë nëse do të kishte dijeni për pretendimet e ngritura në lidhje me gjendjen psikike të autorit.

Gjithashtu mosveprimi i prokurores, konsideruar si shkelje e procedurave të gjykimit në një gjykim të rregullt, për të parë se për çfarë dokumentesh bëhej fjalë nga mbrojtja, mendojmë se nuk ka ndikim në vendimmarrjen e gjykatës, e cila pasi i ka administruar këto akte, i vlerëson vetë ato, duke pasur të gjitha mundësitë ligjore për të vepruar me caktimin e masës së shtrimit të përkohshëm në një spital psikiatrik dhe jo atë të arrestit në burg. Për më tepër, neni 290 i K.Pr.P, ngarkon gjykatën për vendosjen e shtrimit të përkohshëm në spital psikiatrik, kur personi është i sëmurë mendërisht. Sipas këtij neni: "Kur personi që duhet arrestuar është i sëmurë mendërisht dhe për këtë shkak përjashtohet apo pakësohet shumë zotësia e të kuptuarit ose vullnetit, gjykata

në vend të paraburgimit mund të urdhërojë shtrimin e përkohshëm në një institucion psikiatrik, duke caktuar masat e nevojshme për të parandaluar rrezikun e ikjes.”

Po kështu edhe në parashikimet e neneve 43/1⁶ dhe 46/1⁷, të Kodit të Procedurës Penale, ligji i njeh të drejtën gjykatës që mund të vendosë edhe kryesisht kryerjen e ekspertimit psikiatrik apo dhe shtrimin e të pandehurit në një institucion psikiatrik. Kjo do të thotë se në kushtet kur në fashikullin e masës së sigurimit (fashikull që e administron vetë gjykata dhe jo prokurori) gjendeshin të administruara edhe dokumentet për gjendjen psikike të pretenduar, gjykatat, si ajo e shkallës së parë ashtu dhe gjykata e apelit, mund të vepronin kryesisht, pavarësisht kërkesës së prokurorit.

Nisur nga sa sipër u argumentua, konkluzioni i ILD-së, që pasiviteti i prokurorit ka ndikuar në mos marrjen e nismave të tjera gjatë gjykimit, nga gjykatat (shkallë e parë dhe apel) nuk ka bazë, pra nuk qëndron.

I njëjti arsyetim vlen edhe për sa i përket ndikimit tek prokurori i apelit, sepse prokurori i caktuar për përfaqësimin e çështjes në Gjykatën e Apelit, përgatit konkluzionet e tij, duke u bazuar në dosjen gjyqësore (fashikullin e gjykatës) që ka shoqëruar ankimin, dhe jo në fashikullin që administron prokurori i çështjes në shkallën e parë. Pra edhe ai kishte mundësi që të njihej me përmbajtjen e akteve të paraqitura nga avokati mbrojtjes të administruara në fashikullin e gjykimit. Si rrjedhojë pasiviteti i prokurorit nuk mund të ndikojë dhe as nuk ka ndikuar, në qëndrimin e mbajtur në gjykimin e çështjes nga prokurori i apelit.

Për sa i përket asaj që konsiderohet nga ILD si një tjetër pasojë, konkretisht “mungesa e një mbikëqyrje efektive dhe mungesa e kujdesit të specializuar sidomos për sa i përket trajtimit mjekësor që ka privuar të pandehurin nga një trajtim në përputhje me gjendjen e tij shëndetësore”, Këshilli ka mendimin se nga provat e administruara në dosjen hetimore të ILD-së, rezulton se fakti i pretenduar nuk ekziston, pra pasoja e privimit të pandehurit nga trajtimi mjekësor nuk ka ardhur.

Rezulton e provuar nëpërmjet shkresës nr.798, datë të 21.02.2020 të IEVP “Jordan Misja” dhe praktikës shoqëruar, se me të pandehurin, në datën 26.12.2019, është realizuar konsultë psikiatrike në ambientet e IEVP-së, duke u konkluduar se vuante nga “skizofrenia” dhe për rrjedhojë është trajtuar me mjekim të përshtatshëm për këtë diagnozë. Po kështu në datat 27.12.2019 dhe 17.02.2020 është konsultuar sërish nga mjeke psikiatër dhe është konstatuar në vijim një gjendje emocionale të ekuilibruar.

Gjithashtu rezulton e provuar se as nga IEVP “Jordan Misja”, prokurorja, nuk është vënë në dijeni të faktit se ai ndiqej dhe mjekohej nga mjek psikiatër, detyrim ky i lindur nga VKM-ja nr.437 datë 20.05.2015 “Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve”.

Në mungesë të vërtetimit të ndonjë pasojë për palët në procedim, nuk mund të konsiderohet e kryer shkelja disiplinore që referon ILD, sepse ligji dhe konkretisht neni 102, pika 1, germa dh) e ligjit nr. 96/2016, “Për Statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, përcakton shprehimisht se “veprimi ose mosveprimi i magjistratit duhet të sjellë dëm për palët në një procedurë hetimore, në kundërshtim me ligjin”.

Gjithashtu veprimet apo mosveprimet e prokurorit në procedimin penal në ngarkim të të pandehurit, B.H nuk përbëjnë as ndonjë shkelje tjetër disiplinore, pasi nuk klasifikohen sipas

⁶ Kur ka arsye të çmohet se për shkak të sëmundjes mendore të shkaktuar pas ngjarjes i pandehuri nuk është në gjendje të marrë pjesë me vetëdije në procedim, gjykata vendos, edhe kryesisht, ekspertimin

⁷ Në çdo rast kur gjendja mendore e të pandehurit tregon se ai duhet të kurohet, gjykata, vendos, edhe kryesisht shtrimin e të pandehurit në një institucion psikiatrik

asnjerit prej parashikimeve të tjera të nenit 102 të ligjit 96/2016, në lidhje me shkeljet disiplinore gjatë ushtrimit të detyrës.

PËR KËTO ARSYE,

Në përfundim të shqyrtimit të procedimit disiplinor nr. 251/31, datë 21.07.2020, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në nenin 146, pika 2, germa a), e ligjit nr. 96/2016, "Për Statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, sot, në datën 17.11.2020,

VENDOSI

1. Rrëzimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedim disiplinor nr. 251/31, datë 21.07.2020, ndaj prokurores
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim, nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i njoftohet palëve, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe prokurores brenda 5 (pesë) ditëve nga data e shpalljes së vendimit dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.
3. Palët kanë të drejtë të ankimojnë këtë vendim në gjykatën kompetente.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

ZV/KRYETARI
ALFRED BALLA

ANËTAR
TARTAR BAZAJ

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
SANDËR BECI

ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

ANËTAR
VATË STAKA

KRYETARI
GENT IBRAHIMI

Kundër



ANËTAR
NURIHAN SEITI

Kundër

MENDIM PARALEL

Ndryshe nga arsytimi i shumicës në lidhje me shkaqet e rrëzimit të kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nr. 253/31 prot., datë 21.07.2020 për procedim disiplinor të prokurores ne anëtarët Esmeralda Keshi, Kostaq Beluri dhe Vatë Staka nuk pajtohemi me qëndrimin e arritur nga shumica se: "... mosveprimi i prokurores, konsiderohet si shkelje e procedurave të gjykimit sipas praktikës gjyqësore për një gjykim të rregullt, por kërkesa për procedim disiplinor rrëzohet pasi nga veprimet apo mosveprimet e prokurores, nuk konstatohet ardhja e ndonjë pasojë për palët në procedimin penal ndaj shtetasit B.H ...", për arsytet që vijojnë.

Gjatë shqyrtimit të seancës së vleftësimit të arrestit dhe caktimit të masës së sigurimit, jo domosdoshmërisht prokurori duhet të shprehet në lidhje me dokumentet e paraqitura në seancën e vleftësimit të arrestit dhe caktimit të masës së sigurimit nga ana e mbrojtësit të të arrestuarit dhe për pasojë vlerësoj se nga ana e prokurores nuk është shkelur asnjë rregull procedural në lidhje me administrimin e këtyre akteve në dosjen gjyqësore, sa kohë që në Kodin e Procedurës Penale, nuk ka një detyrim të shkruar për këtë moment procedural.

Neni 2 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: "*Dispozitat procedurale caktojnë rregullat për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, të hetimit dhe gjykimit të veprave penale, si dhe të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Këto rregulla janë të detyrueshme për subjektet e procedimit penal, për organet shtetërore, personat juridikë dhe shtetasit....*"

Ndërkohë në pikën 2 të nenit 259 "Seanca e vleftësimit" të K.Pr.Penale, parashikohet se: "*Prokurori tregon shkaqet e arrestimit ose të ndalimit. Pas kësaj gjykata dëgjon të arrestuarin ose të ndaluarin dhe mbrojtësin ose vetëm këtë të fundit, kur i arrestuari a i ndaluari ka refuzuar të paraqitet. Provat e marra në këtë seancë konsiderohen si të marra në gjykim por, me kërkesën e palëve, ato mund t'i nënshtrohen debatit gjyqësor gjatë shqyrtimit të çështjes në themel....*" dhe nga përmbajtja e kësaj dispozite e cila rregullon seancën e vleftësimit të arrestit/ndalimit nuk rezulton i parashikuar në mënyrë taksative nëse organi i akuzës duhet të njihe dhe të shprehet në lidhje me aktet e paraqitura nga pala tjetër apo qëndrimin e mbajtur nga pala tjetër. Sikurse shprehet kjo dispozitë, provat e marrë në këtë seancë mund t'i nënshtrohen debatit gjyqësor gjatë shqyrtimit të çështjes në themel.

Për sa kohë nuk ka një parashikim taksativ mbi detyrimin e organit të akuzës, që në seancën e vleftësimit të mbajë një qëndrim mbi aktet dhe faktet e parashtruar nga i arrestuari/ndaluar apo mbrojtja e tij, duke dhënë mundësinë që aktet e administruara në seancë, nëse ju jepet vlera e provës nga ana e gjykatës, t'i nënshtrohen debatit gjyqësor gjatë gjykimit në themel, nuk mund të thuhet se kemi shkelje procedurale.

Në vendimin e saj nr.13 datë 24.04.2018 Gjykata Kushtetuese shprehet se: "...12. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se parimi i kontradiktoritetit dhe i barazisë së armëve në gjykimin penal, i garantuar nga neni 31 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i KEDNJ-së, kërkon që argumentet e mbrojtjes të paraqiten dhe të dëgjohen njëjloj si ato të prokurorit. Ky

parim presupozon që secilës palë duhet t'i ofrohen mundësi të arsyeshme për të paraqitur pretendimet për çështjen, në kushte të tilla që të mos e vënë në dizavantazh me palën tjetër (shih vendimin nr.5, datë 17.02.2003 të Gjykatës Kushtetuese). Në lidhje me paraqitjen e administrimin e provave në gjykim, Gjykata ka mbajtur qëndrim se provat paraqiten dhe marrin vlerën e tyre në debatin gjyqësor, ku secila palë ka mundësi për të paraqitur argumentet e veta në një pozitë jo më pak të favorshme se pala tjetër (shih vendimin nr.16, datë 27.03.2012 të Gjykatës Kushtetuese)."

Duke mbajtur në konsideratë fakti se parimi i kontradiktoritetit, sikurse shpohet edhe Gjykata Kushtetuese është një parim që garanton të drejtën secilës prej palëve në proces, për të paraqitur argumentet e saj në një pozitë jo më pak të favorshme se pala tjetër, mbetet në çmimin e palëve se si dhe se sa do ta shfrytëzojnë këtë të drejtë. Sigurisht që organi i akuzës, si përfaqësues i shtetit, ka një marzh shumë më të ngushtë në çmuarjen e ushtrimit ose jo të kësaj të drejtë, por për sa kohë nuk ka një parashikim taksativ për ushtrimin ose jo të kësaj drejthe gjatë seancës së vlefësisimit, nuk mund të thuhet se kemi shkelje procedurale.

Nga procesverbali i seancës gjyqësore të datës 11.12.2019 rezulton se nga ana e mbrojtjes së të arrestuarit B.Hasani është thënë: "... E lëmë në çmim të gjykatës kërkesën e prokurorisë për vlefësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë. Nuk jam dakord me kërkesën e dytë të prokurorisë për caktimin e masës së sigurimit arrest në burg, pasi nuk ekzistojnë kushtet dhe kriteret për caktimin e kësaj mase shtrënguese. Sqarojmë gjykatën i mbrojturi prej meje është kryefamiljar, me katër fëmijë, njëherazi ju bëj me dije faktin se shtetasi B.H është në gjendje jo të mirë shëndetësore, është invalid, ndaj kërkoj caktimin e një mase sigurimi më të butë, se masa e kërkuar prej organit të akuzës. Si prova paraqes aktet ...Certifikatë e përbërjes familjare ... Vlerësim psikologjik Vërtetim nga KMCAP ...". Në vijim prokurorja është shprehur "Jam dakord të bëhen pjesë e fashikullit të gjykatës aktet e paraqitura nga mbrojtja."

Sikurse rezulton nga të dhënat e pasqyruara në procesverbalin e seancës së vlefësisimit të arrestit dhe caktimit të masës së sigurimit, mbrojtja e të arrestuarit B.H ka paraqitur tre dokumente të cilat në çmimin e tij duhet ti shërbenin, për të bindur gjykatën për caktimin e një mase sigurimi më të butë se sa ajo e kërkuar nga prokurori, por pa saktësuar se cila do të ishte masa konkrete e përshtatshme për personin e mbrojtur prej tij. Një qëndrim i tillë nga ana e mbrojtjes, nuk krijon hapësirë për debat gjyqësor, pasi nuk është një kërkesë specifike, e cila mund të kundërshtohet mbi bazueshmërinë e saj ose jo. Për këtë arsye, marzhi i çmuarjes nga ana e prokurores, për të mos u njohur me aktet e paraqitura nga mbrojtja, në rastin konkret nuk është në shkelje të asnjë dispozite procedurale të parashikuar dhe të rregulluar nga legjislacioni në fuqi.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë në disa pika të raportit hetimor, ka shprehur qëndrimin se: "Në analizë të fakteve të konstatuara, rezultoi se mosveprimi i prokurores në drejtim të verifikimit të përgjegjshmërisë së të pandehurit B. H. solli si pasojë pengimin e aktorëve të tjerë të sistemit për të disponuar me masa të përshtatshme ndaj shëndetit mendor..."

Gjatë sqarimit të dhënë në seancë dëgjimore, Inspektori i Lartë i Drejtësisë theksoi se me aktor kishte parasysh gjykatën e shkallës së parë dhe të apelit, mosveprimi i prokurores nuk ka asnjë ndikim për arsyen se është gjykata ajo që drejton dhe administron seancën gjyqësore që ka marrë

në dorëzim dhe ka bërë vlerësimin nëse duhet t'i administrojë apo jo si prova aktet e paraqitura nga avokati mbrojtjes, sikurse vërtetohet se ka vepruar edhe në rastin konkret.

Nuk mund të thuhet se me mosveprimet e saj prokurorja _____ ka penguar aktorët e tjerë të sistemit të drejtësisë, pasi rezulton e provuar se prokurorja, gjatë seancës së datës 11.12.2019 është shprehur se ishte dakord që aktet e paraqitura nga mbrojtja të bëheshin pjesë e fashikullit të gjykatës.

Nisur nga sa sipër u argumentua, konkluzioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që pasiviteti i prokurorit ka ndikuar në mos marrjen e nismave të tjera gjatë gjykimit, nga gjykatat (shkallë e parë dhe apel) rezulton i pabazuar.

Sa më sipër arrihet në përfundimin se nga ana e prokurores _____ nuk janë konsumuar elementët e ndonjë shkelje disiplinore, pasi sjellja e saj gjatë seancës gjyqësore të datës 11.12.2019 është tërësisht e bazuar në ligj.

Mendimin tonë e argumentuam si mendim paralel, pasi pavarësisht nga mendimi i ndryshëm dhe shkaqet e tij, zgjidhja e çështjes konkrete është e njëjtë me atë të shumicës.

ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

ANËTAR
VATË STAKA

MENDIM PAKICE

Në mbledhjen plenare të datës 17.11.2020, Këshilli i Lartë i Prokurorisë (*Këshilli*) shqyrtoi kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (*ILD*) për vendosjen e masës disiplinore "*Vërejtje Publike*", të parashikuar nga neni 107 i Ligjit nr. 96/2016 "*Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve*", i ndryshuar, ndaj prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, E.K.

Në atë mbledhje Këshilli vendosi, me votat e shumicës së anëtarëve, rrëzimin e propozimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për caktimin e masës disiplinore.

Duke qenë se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën e kolegëve të mi, unë votova në favor të pranimit të kërkesës së ILD për arsyet të cilat po i parashtrij në këtë mendim pakice që i bashkëngjitet arsyetimit të vendimit të Këshillit:

Në parashtrimet e tij, ILD arsyetonte (*në mënyrë të përmbledhur*) si më poshtë:

Në seancën gjyqësore për vleftësimin e masës së sigurisë (*arrest në burg*) të propozuar nga prokurori E.K, mbrojtja e të akuzuarit i kërkoi gjykatës që të administronte 3 akte / dokumente të cilat, sipas mbrojtjes, përbënin prova që do duhej t'a bindnin gjykatën për të ndryshuar masën e sigurisë të kërkuar nga prokurori. Dokumentet në fjalë ishin:

- i) *Certifikatë e përbërjes familjare ...*
- ii) *Vlerësim psikologjik i lëshuar nga qendra komunitare e shëndetit mendor nr.3.*
- iii) *Vërtetim datë 11.09.2018 nga KMCAP i kategorizuar si person me aftësi të kufizuar".*

Gjatë seancës, prokurori E.K shprehu dakordësinë që dokumentet e sipërpërmendura të futen në dosjen gjyqësore dhe të administrohen nga gjykata në marrjen e vendimit për masën e sigurisë pa u njohur me to dhe pa debatuar për pranueshmërinë e tyre (*të dokumenteve*) si prova.

Në këto kushte, ILD arsyeton se prokurori ka konsumuar shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, germa *dh*, i Ligjit nr. 96/2016 "*Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve*" duke qenë se mosveprimi i prokurorit ka sjellë dëme për palët në procesin gjyqësor në kundërshtim me ligjin. ILD arsyetoi se dëmi ka ardhur në formën e pamundësimin të hallkave të mëtejshme të procesit gjyqësor (*prokurori i apelit dhe gjyqtarët e apelit, si dhe gjyqtari i seancës paraprake*) për t'u njohur me dokumentet e paraqitura nga palët⁸ dhe për t'i përdorur ato në fazat e mëtejshme të gjykimit.

⁸ ILD në disa pika të raportit hetimor, ka shprehur këtë qëndrim të tij duke e përmbledhur në pikën 7.3 përfundimin e arritur se: "Në analizë të fakteve të konstatuara, rezultoi se mosveprimi i prokurorit E. K në drejtim të verifikimit të përgjegjshmërisë së të pandehurit B. H. solli si pasojë pengimin e aktorëve të tjerë të sistemit për të disponuar me masa të përshtatshme ndaj shëndetit mendor. Nga ana tjetër ky mosveprim solli dërgimin e çështjes në gjykim duke u kërkuar deklarimi fajtor dhe dënimi i tij me burgim, rrjedhojë e të cilës ishte dhe vijimi i procedurave gjyqësore me

Këshilli u pajtua me pozicionin e ILD sipas të cilit dështimi i prokurorit për t'u njohur me aktet e paraqitura nga mbrojtja në seancën e caktimit të masës së sigurimit personal, përbën shkelje të rregullave të procedurës penale për mbledhjen e provave në seancë gjyqësore.

Në respekt të parimit kushtetues të procesit të rregullt ligjor, prokurori e ka për detyrë të njihet me aktet e depozituara në seancë nga pala mbrojtëse për t'u siguruar për pranueshmërinë e tyre si prova në përputhje me parashikimet e nenit 149 të Kodit të Procedurës Penale si dhe për të rishikuar (*nqs është rasti*) pozicionet e tij, pavarësisht detyrimit të gjykatës për të bërë të njëjtat verifikime.

Çdo veprim / mosveprim i prokurorit që bie ndesh me këtë detyrim duhet të konsiderohet në çdo rast shkelje e normave dhe parimeve procedurale të cilat qëndrojnë në themel të procesit të rregullt në fazën e shqyrtimit gjyqësor të masave të sigurisë, pavarësisht se Kodi i Procedurës Penale nuk parashikon në mënyrë taksative detyrimin e prokurorit për t'u njohur me aktet e paraqitura nga mbrojtja në këtë fazë të gjykimit.

Shpresoj që përmes qëndrimit të mbajtur mbi këtë çështje Këshilli ka vendosur një precedent të rëndësishëm e të qartë për të gjithë prokurorët.

Ndonëse Këshilli ra dakord me pozicionin e ILD në lidhje me kryerjen e një shkeljeje procedurale nga prokurori (*pra Këshilli gjykoj se prokurori ka kryer shkelje*), shumica e anëtarëve të Këshillit nuk e pranoi arsyetimin e ILD sipas të cilit shkelja e prokurorit solli pasoja të paligjshme për palët në proces duke penguar aktorët e tjerë të sistemit (*gjyqtari i seancës paraprake, prokurori i apelit dhe gjyqtarët e apelit*) për të disponuar me masa të përshtatshme sigurie që do të mbanin në konsideratë shëndetin e brishtë mendor të të pandehurit. Sipas tyre, duke qënë se dokumentet e paraqitura nga mbrojtja gjatë seancës së vleftësimit të masës së sigurisë u përfshinë në dosjen gjyqësore ato mund të konsultoheshin lirisht nga aktorët e sipërpërmendur dhe mund t'i nënshtroheshin debatit gjyqësor në fazat e mëtejshme të gjykimit (*gjykimi në apel i masës së sigurisë, seanca paraprake dhe seanca e gjykimit në themel të çështjes*). Për këtë arsye, shumica konkludoi se nuk mund të pretendohet se aktorët e tjerë të sistemit (*të përmendur më lart*) janë penguar për të njohur dhe përdorur aktet e paraqitura nga mbrojtja në seancën e vleftësimit të masës së sigurisë.

Pikërisht këtu ndahem me kolegët e shumicës. Unë jam i mendimit se provat që janë relevante për gjykimin e masës së sigurisë (*të tilla ishin provat e paraqitura nga mbrojtja në seancën e vleftësimit të masës së sigurisë*) duhet të debatohen në seancën gjyqësore përkatëse (*pra pikërisht në seancën e vleftësimit të masës së sigurisë në shkallë të parë*). Debatimi i tyre i mëvonshëm, qoftë në apel, qoftë në seancën paraprake, qoftë në gjykimin në themel të çështjes nuk mund të zëvendësojë debatin gjyqësor gjatë vendimmarrjes për masën e sigurisë në shkallë të parë pasi fazat e mëtejshme të gjykimit kanë qëllime dhe objektiva të tjera, të ndryshme nga faza e shqyrtimit të masës së sigurisë në shkallë të parë. Për këtë arsye, është e natyrshme që gjykimi në këto faza të mëvonshme të mos i kushtojë vëmendjen e duhur provave që kanë për qëllim të ndikojnë në vendimin për masën e sigurisë.

zhvillimin e seancës së hetimeve paraprake dhe më pas dërgimi për gjykim dhe caktimi i seancës gjyqësore, janë veprime të cilat zgjatën qëndrimin e shtetasit B.H në ambientet e IEVP "Jordan Misja". Mosveprimi i prokurorit nuk rezultoi të jetë shkak i vdekjes së shtetasit B.H.

Përsa më sipër jam dakord me pozicionin e ILD sipas të cilit dështimi i prokurorit për t'u njohur me provat e paraqitura nga mbrojtja në seancën e vleftësimit të masës së sigurisë jo vetëm që përbën shkelje të rregullave dhe parimeve të procedurës penale (*siç e pranoi edhe Këshilli*) por, për më tepër, ai dështim ka sjellë edhe dëme për palët në proces (*siç kërkon neni 102/dh i ligjit për statusin*) duke zbehur objektivisht mundësinë e aktorëve të tjerë të sistemit për të disponuar me masa të përshtatshme që do të adresonin në mënyrë adekuate problemet që erdhën më pas për shkak të shëndetit të brishtë mendor të shtetasit B.H.

Për sa më sipër, bazuar në konkluzionet e sipërcituara, vlerësoj se propozimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masës disiplinore "Vërejtje publike" për prokurorin E.K ishte i drejtë dhe do duhej të ishte mbështetur nga Këshilli.

**KRYETARI
GENT IBRAHIMI**

